



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Regulatory Authority of Electronic and Postal Communications
Regulatorni Autoritet za Elektronske i Poštanske Komunikacije

Nr. Prot. 025/B/13

Klasa: 01/13

Nr. i Regjistrimit: 19

Miraturar me Vendimin Nr. 380 të Bordit të ARKEP (Ref. Nr. Prot. 024/B/13)

RREGULLORJA TEKNIKE
PËR RADIO PAJISJET DHE PAJISJET TERMINALE TELEKOMUNIKUESE
DHE KOMPATIBILITETIT ELEKTROMAGNETIK
(NJOHJA E KONFORMITETIT)

KAPITULLI I

Baza ligjore, Qëllimi e Fushëveprimi, Definicionet dhe Parimet

Neni 1

Baza Ligjore

- (1) Kjo rregullore është nxjerr në mbështetje të dispozitave të neneve; neni 9, paragrafi 3) nën-paragrafi 3.8); neni 10 paragrafi 4) neneve të Kreut XV, neni 94, neni 95 dhe neni 96 i Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si; Ligji*); Direktivës 1999/5/EC të nxjerr nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli i Evropës, të datës; 9 Mars 1999 mbi Pajisjet e Radiove dhe Pajisjeve Terminale (fundore) të telekomunikimeve dhe njohjes së dyanshme të konformitetit së tyre (*tutje referuar si; Direktiva R&TTE*); Vendimit të Komisionit Evropian të datës; 6 Prill 2000 për klasifikimin e radio pajisjeve dhe pajisjeve terminale dhe identifikuesit shoqërues (2000/299/EC).

Neni 2

Qëllimi dhe fushëveprimi

- (1) Kjo Rregullore përcakton kushtet themelore për lidhje të radio-pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese, obligimet që kanë të bëjnë me informatat për specifikat e ndërfaqeve dhe lidhjen me radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, procedurat dhe kushtet për daljen, shitjen dhe vënien në përdorim në Republikën e Kosovës të radio pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese, përfshi vlerësimin e konformitetit.
- (2) Kjo rregullore zbatohet nga prodhuesit, përfaqësuesit e autorizuar të prodhuesve, subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në tregun e Republikës e Kosovës dhe nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

- (3) Pajisjet, të cilat nuk janë në përputhje me kriteret e vendosura në këtë rregullore, mund të ekspozohen në panairë ose ngjarje të natyrave të ngjashme, me kusht që një shënim i qartë dhe i dukshëm në njërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës të tregoj se një pajisje e tillë nuk mund të vendoset në treg pa u përmbushur kriteret në fjalë.

Neni 3 **Dispozita të përgjithshme**

- (1) Kjo Rregullore përcakton;
- 1.1 Kërkesat themelore dhe procedurat e njohjes së konformitetit në lidhje me pajisjet e mëposhtme;
- 1.1.1. Pajisje terminale për rrjetin e komunikimeve elektronike (*tutje referuar si – pajisje terminale*);
- 1.1.2. Radio pajisje dhe,
- 1.1.3. Pajisjen që njëkohësisht është pajisje terminale dhe radio pajisje;
- 1.2 Procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e pajisjeve (*tutje referuar – pajisje komunikimi*) sipas paragrafit 1.1 të këtij neni;
- 1.3 Procedurat përmes së cilave informacioni, i nevojshëm për të plotësuar funksionet dhe ushtruar mandatin e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP*) do të kërkohen dhe pranohen.
- (2) Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për pajisjet e mëposhtme të komunikimit;
- 2.1 Ato pajisje, të cilat janë menduar vetëm për pranimin e zërit dhe sinjaleve të transmetimit të televizionit.
- 2.2 Ato pajisje që janë menduar për qëllime të mbrojtjes kombëtare dhe përdoren në brezet frekuencore të specifikuara në Planin Kombëtar të Radio frekuencave, të cilat janë alokuar vetëm për përdorim me qëllim të mbrojtjes kombëtare.
- 2.3 Radio pajisjen e radio amatorëve, e cila nuk është shitur, dhënë me qira, apo ofruar ndryshe për të sjellë përfitim (përfshirë edhe komponentët përbërëse për funksionalizim dhe radio pajisje e cila është modifikuar për përdorim personal nga radio amatorët);
- 2.4 Radio pajisje e cila përdoret vetëm për të siguruar rendin publik, mbrojtjen apo sigurinë e Shtetit (përfshirë edhe pasurinë ekonomike kombëtare), si dhe aktivitetet e agjensioneve të sigurisë publike dhe gjyqësorit në fushën e zbatimit të Kodit Penal.

Neni 4 **Definicionet**

- (1) Për qëllim të kësaj Rregulloreje;
- 1.1 Kuptimi apo definicioni i secilës fjalë, frazë apo shprehje, sipas Ligjit gjithashtu do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë Rregullore.
- 1.2 Shprehjet, frazat, dhe shkurtesat e mëposhtme do të kenë kuptimin siç vijon;
- a) **‘Pajisje terminale e telekomunikimit’** do të thotë një produkt që mundëson komunikimin apo komponenti relevant i tij/saj, e cila është menduar të lidhet direkt ose indirekt përmes çfarëdo mënyre në interfejsat e rrjeteve të telekomunikimit publik (mund të thuhet që rrjetet e telekomunikimit të përdorura plotësisht apo pjesërisht

për ofrimin e shërbimeve publike telekomunikuese që janë në dispozicione të telekomunikimit);

- b) **'Radio pajisje'** do të thotë një produkt që mundëson komunikimin apo komponentët relevante të tij/saj, e aftë për komunikim përmes mjeteve të emetimit dhe/ose pranimit të radio valëve duke shfrytëzuar spektrin e ndarë për radio komunikime tokësor/hapësinor;
- c) **'Radio valë'** do të thotë valë elektromagnetike të frekuencës prej 9 kHz deri 3 000 GHz, e shpërndarë në hapësirë pa nevojën e linjave të veqanta;
- d) **'Interfejs'** do të thotë:
 - (i) Një pikë terminuese e rrjetit, që është lidhja fizike e cila i mundëson një shfrytëzuesi qasje në rrjetin publik të telekomunikimeve, dhe/ose
 - (ii) Një interfejs ajror që specifikon shtegun e dhe specifikimet teknike të radio pajisjes;
- e) **'Lloji i pajisjeve'** do të thotë lloji që identifikon tipin e veçantë të aparateve të cilat sipas Direktivës konsiderohen të njëjta dhe ato interfejsa për të cilat aparatet janë dizajnuar. Aparatet mund t'i përkasin më shumë se një lloji të pajisjes;
- f) **'Standard i harmonizuar'** do të thotë specifikacioni teknik i adoptuar nga organi i akredituar i Standardeve sipas mandatit të dhënë nga komisioni në përputhje me procedurat e dhëna në Direktivën 98/34/EC për qëllime të krijimit të Kërkesës Evropiane, me të cilën nuk është i detyrueshëm harmonizimi.
- g) **'Interferencë e dëmshme'** do të thotë interferencë e cila rrezikon funksionimin e shërbimeve të radio navigimit apo të shërbimeve tjera të sigurisë apo të cilat ndryshe degradojnë seriozisht, pengojnë apo vazhdimisht interferojnë në shërbimet e radio komunikimeve, të cilat operojnë në pajtim me rregulloret e aplikueshme kombëtare.
- h) **'ARKEP'** do të thotë Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- i) **'PNO'** nënkupton operatori publik i rrjetit.

KAPITULLI II

Kërkesat Themelore dhe standardi që duhet të aplikohet

Neni 5

- (1) Kërkesat themelore të mëposhtme janë specifikuar që:
 - 1.1 Radio pajisja do të siguroj shfrytëzimin efikas të spektrit radio frekuencor, të alokuar për radio komunikim të burimeve tokësore dhe hapësinore si dhe të orbitave, pa shkaktuar radio interferencë të dëmshme;
 - 1.2 Aktiviteti i pajisjes terminale nuk do të shkaktoj dëm në rrjetin publik të komunikimeve elektronike apo në funksionimin e tyre;
 - 1.3 Pajisja terminale do të ndërveproj me rrjetin publik të komunikimeve elektronike për krijimin, ndryshimin, klasifikimin e tarifave, mirëmbajtjen apo shkyçjen e një lidhjeje reale ose virtuale;
 - 1.4 Pajisja terminale, përmes rrjetit publik të komunikimeve elektronike, do të ndërveprojë me pajisjet tjera dhe do të sigurojë kyçjen me interfejsin e specifikuar;

- 1.5 Kërkesat e akteve rregullatore në lidhje me sigurinë elektrike të pajisjes do të aplikohen edhe për pajisjen radio dhe/ose terminale me tension deri në 50 V për rrymën alternative apo deri në 75 V për rrymën direkte;
- 1.6 Kur përdoret pajisja radio dhe terminale për qëllimin e synuar, fusha elektromagnetike e rrezatuar nga pajisja nuk do të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut;
- 1.7 Kërkesat e akteve rregullatore në lidhje me kompatibilitetin elektromagnetik të pajisjeve do të aplikohen edhe për pajisjen radio dhe terminale, dhe
- (2) Paragrafët 1.6 dhe 1.7 të këtij neni nuk do të aplikohen për pajisje radio dhe/ose terminale, të cilat janë përdorur, apo nëse shpërndarja ose paraqitja e këtyre pajisjeve në treg është bërë para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
- (3) Operatorët e komunikimeve elektronike janë të detyruar të përshkruajnë dhe publikojnë parametrat e pikave terminuese të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të tyre në pajtim me Aneksin 5 të kësaj Rregulloreje.
- (4) ARKEP në ueb faqen e saj do t'i ofroj lidhjen (linkun) e listës së standardeve të aplikueshme, të cilat mund të aplikohen për plotësimin e kërkesave themelore të kësaj Rregulloreje (*këtej e tutje referuar si – standardet e aplikueshme*).
- (5) Nëse pajisja radio dhe/ose terminale është në pajtueshmëri me standardet e aplikueshme apo me pjesë të tij dhe nëse këto standarde apo pjesë të tyre janë aplikuar në mënyrë të duhur dhe i janë atribuar pajisjes radio dhe terminale, do të konsiderohet se kjo pajisje radio dhe/ose terminale i plotëson kërkesat themelore, të cilat tërësisht janë të përfshira nga standardet e aplikueshme apo pjesë të tyre.

KAPITULLI III

Vlerësimi dhe njohja e Konformitetit

Neni 6

Procedura e Njohjes së Konformitetit

- (1) ARKEP, është autoriteti përgjegjës për njohjen e konformitetit për radio pajisjet dhe pajisjet terminale. Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për pajisjet radio, që synohet të prodhohen, importohen, vendosen në treg, me përjashtim të pajisjeve radio që punojnë në frekuenca të harmonizuara.
- (2) Njoftimi për njohjen e konformitetit, duhet të kryhet nga çdo person fizik dhe juridik, nëse është publik ose privat, vendas ose i huaj. Subjekti aplikant është i detyruar të njoftojë ARKEP, **së paku katër (4) javë përpara importimit dhe vendosjes së pajisjeve radio në tregun e Republikës së Kosovës.**
- (3) Pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve janë të identifikuar në dy klasa;
- 3.1 **Lloji 1** do t'i referohet pajisjeve, të cilat mund të vendosen në treg dhe shërbim pa kufizime. Për këtë lloj të pajisjeve, nuk është përcaktuar një identifikues i llojit të pajisjeve. Në këtë kategori janë të përfshira:
- pajisjet fundore të telekomunikacioneve që përfshihen në rrjetet fikse;
 - pajisjet radio jo-transmetuese (pajisjet vetëm marrëse);
 - pajisjet radio, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti;
 - radio-transmetuesit, që punojnë në breza të frekuencave të harmonizuar në Kosovë dhe në vendet e Bashkimit Evropian.

- 3.2 **Lloji 2** do t'i referohet pajisjeve, për të cilat janë aplikuar kufizime gjatë vendosjes në treg ose shërbim. Për këtë lloj të pajisjeve është përcaktuar një identifikues i llojit të pajisjeve. Pajisja e kësaj kategorie duhet të shënohet me një simbol lajmëruar (një rreth me një pikëçuditëse brenda saj si ç'është specifikuar në Aneksin II). Pajisja radio, e cila nuk i përket Llojit 1, përfshihet në Llojit 2.
- (4) ARKEP harton dhe publikon në ueb faqen zyrtare www.art-ks.org një listë të pajisjeve, të cilat mund të importohen dhe të vendosen në treg pa kryer njoftimin dhe procedurën e njohjes së konformitetit. Kjo listë rishikohet periodikisht duke përfshirë në të kryesisht pajisje të Klasës 1) sipas përcaktimeve në faqet e internetit të EC/ERO (*European Commission/European Radiocommunications Office*). Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për të gjitha pajisjet radio, që prodhohen, importohen, vendosen në treg dhe përdoren, me përjashtim të atyre rasteve kur ARKEP nuk duhet të njoftohet.
- (5) Njoftimi duhet të behet duke përdorur formularin e paraqitur në Aneksin III) të kësaj Rregulloreje. Ky formular duhet të nënshkruhet vetëm nga persona të autorizuar të ndërmarrjes.
- (6) Formulari i njoftimit konsiderohet të jetë i plotësuar, kur të gjitha kërkesat lidhur me formën dhe përmbajtjen e tij janë plotësuar. Ky konsiderohet si momenti i fillimit të procesit të njohjes së konformitetit.
- (7) Dokumentacioni bashkëngjitur me formularin e njoftimit duhet të jetë, si më poshtë;
- përshkrimi teknik dhe specifikimet teknike, sipas dokumentacionit të fabrikuesit, ose raportet e testimit,
 - deklarata e konformitetit e lëshuar nga fabrikuesi, dhe/ose opinioni i organizmit evropian të notifikuar, nëse ai është parashikuar nga procedurat e vlerësimit të konformitetit.
- (8) Në procesin e njohjes së konformitetit duhet të merret gjithashtu në konsideratë Plani Kombëtar i Radio-frekuencave, duke refuzuar njohjen e konformitetit për pajisjet radio që përdorin breza radiofrekuence, të cilët në këtë plan janë përcaktuar për qëllime të tjera.
- (9) Në bazë të njoftimit të marrë dhe dokumentacionit bashkëngjitur tij, ARKEP-i pasi shqyrton nëse plotësohen konditat për importimin dhe/ose vendosjen në treg të pajisjes radio sipas kësaj Rregulloreje, konfirmon njohjen e konformitetit.
- (10) Në rastin e mospërputhjes me kushtet e paraqitura në këtë Rregullore, ARKEP-i informon aplikuesin, që pajisja përkatëse radio nuk mund të përdoret në Republikën e Kosovës.
- (11) ARKEP-i mund të refuzojë aplikimin për njohje të konformitetit, nëse është e ndaluar vendosja e një pajisje të caktuar radio në tregun e Bashkimit Evropian.
- (12) Njohja e konformitetit të pajisjeve radio mund të revokohet kur provohet shkelja e kërkesave thelbësore të specifikuara në deklaratën e konformitetit, të lëshuar nga fabrikuesi, ose kur është vërtetuar përdorimi i tij jo në pajtim me Planin Kombëtar të Radio-frekuencave dhe me specifikimet teknike të njoftuara nga apikuesi.
- (13) ARKEP publikon dhe përditëson në faqen zyrtare www.art-ks.org listën e pajisjeve radio, për të cilat është lëshuar konfirmimi i njohjes së konformitetit.
- (14) Përgjegjësia për sigurinë, funksionimin, cilësinë dhe besueshmërinë e pajisjeve radio sipas kërkesave thelbësore, për të cilat është lëshuar njohja e konformitetit, bie plotësisht mbi subjektet që e kanë marrë dokumentin e njohjes së konformitetit.

- (15) Procesi i njohjes së konformitetit është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radio të aplikantit fillestar të njoftimit, me kusht që të jenë identike me atë që është njoftuar.
- (16) Njohja e konformitetit, e cila i lëshohet për herë të parë një aplikuesi, është e vlefshme edhe për çdo subjekt tjetër, i cili ka në zotërim pajisje radio të të njëjtit tip. Procesi i njoftimit është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radio identike të të njëjtit tip, pavarësisht autorit të njoftimit.
- (17) Nuk ekziston një afat limit vlefshmërie për dokumentin e lëshuar të njohjes së konformitetit, përveç atyre rasteve kur mund të jete e specifikuar ndryshe nga ARKEP.
- (18) Për pajisjet e radio-komunikimit me përdorim dhe qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës, jo më shumë se tre (3) muaj, ARKEP në rastet e justifikuara mund të bëjë njohjen e konformitetit me procedurë të përshpejtuar.
- (19) Në përfundim të procedurës së njohjes së konformitetit, ARKEP-i regjistron në bazën e të dhënave, tipin e pajisjes, parametrat përkatës dhe subjektin, i cili ka dërguar njoftimin.
- (20) Informacionet e fituara gjatë procesit të njohjes së konformitetit do të jene të disponueshme për aktivitetet e ARKEP-it në procesin e inspektimit, radio monitorimin e spektrit frekuencor dhe në mbikëqyrjen e tregut.

Neni 7 Vlerësimi i Konformitetit

- (1) Prodhuesi duhet të siguroj procesin e prodhimit ashtu që pajisjet radio dhe terminale, që do të prodhohen të jenë në përputhje me kërkesat themelore.
- (2) Procedurat e vlerësimit të konformitetit sipas anekseve 2, 3, 4 dhe 5, të përshkruara në Direktivën R&TTE, duhet të përdoren për të demonstruar përputhjen e pajisjeve me kërkesat themelore.
- (3) Në fund të procedurës së vlerësimit, prodhuesi harton një deklaratë të shkruar të konformitetit të pajisjes sipas kërkesave themelore.

KAPITULLI IV Vendosja e shenjës

Neni 8

- (1) Në mënyrë që të identifikohet një pajisje radio dhe/ose terminale, prodhuesi i këtyre prodhimeve do të vendos një shenjë tek secila pajisje e tillë, e cila do të përmbaj shënimet si në vijim;
 - 1.1 Titulli i prodhuesit ose emri i personit të tillë, i cili është përgjegjës për vendosjen në treg të këtyre pajisjeve; dhe
 - 1.2 Numri i llojit ose modeli i kësaj pajisjeje, Numri i serisë së prodhimit, sikurse edhe numri serik (numri i fabrikimit) i produktit.
- (2) Nëse personi i referuar në paragrafin 1.1 të këtij neni është person fizik atëherë emri dhe mbiemri do të shënohen në vendin e titullit.
- (3) Nëse, pas vërtetimit të konformitetit të pajisjes radio me kërkesat themelore të Planit Kombëtar të Radio Frekuencave apo me kërkesat e lejes për përdorim të përbashkët të ndarjes së radio frekuencave, është e nevojshme që të shikohet edhe kompletimi i veçantë

i komponentëve të këtyre radio-pajisjeve, prodhuesi do të etiketoj secilën komponentë plotësuese të këtyre pajisjeve me shenjëzimin e referuar në paragrafin 1) të këtij neni, zëvendësimi i të cilit mund të ndikoj në konformitetin e këtyre pajisjeve me kërkesat e referuara.

- (4) Secila pjesë e pajisjes radio dhe/ose terminale që përputhet me kërkesat themelore, do të etiketohet me shenjëzim CE nga prodhuesi apo përfaqësuesi i autorizuar i tyre në Kosovë në pajtim me Aneksin I) të kësaj Rregulloreje.
- (5) Nëse një apo më shumë organe të certifikimit janë të përfshira në vlerësimin e konformitetit, prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar në Kosovë do të përdorë në shenjëzimin e pajisjeve radio dhe/ose terminale numrat identifikues të këtyre organeve të certifikimit, duke i vendosur ato tek shenjëzimi CE në anën e djathtë në nivel me shenjëzimin CE. Lartësia e numrit identifikues do të jetë e barabartë me lartësinë e shenjëzimit CE.
- (6) Nëse kushtet për përdorimin e pajisjes radio dhe/ose terminale dhe brezet frekuencore nuk janë harmonizuar në Kosovë, apo mund të ketë kufizime apo ndalime rreth vënies në qarkullim, shpërndarje apo përdorim të tyre në Kosovë, prodhuesi apo përfaqësuesi i autorizuar do të shfrytëzoj në shenjëzim identifikuesin e llojit të pajisjes së komunikimit (Aneksi II) ashtu që pajisjet radio dhe/ose terminale të përputhen me kërkesat e shëndetit publik apo me kërkesat e shfrytëzimit sa më të përshtatshëm dhe efikas të spektrit të radio frekuencave apo të mos shkaktohet radio interferencë e dëmshme, duke përfshirë edhe interferencën e specifikuar për llojet e radio komunikimit apo sistemet e radio komunikimit në Planin Kombëtar të Radio Frekuencave (*tutje referuar si - 'pajisje komunikues e Llojit 2'*).
- (7) Shenjëzimi i referuar në paragrafët 1, 4, 5, dhe 6 të këtij neni do të vendosen në pajisjet radio dhe/ose terminale apo në disk të të dhënave të pajisjes së veçantë të komunikimit ashtu që shenjëzimi do të ishte i pashlyeshëm, lehtë i dukshëm dhe i lexueshëm.
- (8) Shenjëzimi referuar në paragrafët 4, 5, dhe 6 të këtij neni do të vendoset si shtesë në paketimin e pajisjes së komunikimit (nëse ka ndonjë) dhe në dokumentet që do të bashkëngjiten në pajisje radio dhe/ose terminale.
- (9) Kur vendoset shenjëzimi tjetër në pajisje radio dhe/ose terminale, nuk duhet ta mbuloj shenjëzimin e referuar në paragrafët 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni.
- (10) Është e ndaluar që të vendoset shenjëzimi në pajisje radio dhe/ose terminale, pavarësisht se këto pajisje përputhen me kërkesat themelore, që janë të ngjashme me shenjëzimin e referuar në paragrafin 4) të këtij neni dhe kësaj mund të ç'orientoj palët e treta në lidhje me kuptimin dhe formën e tij.
- (11) Nëse pajisja radio dhe/ose terminale është pjesë integrale e një pajisjeje tjetër, e cila është e gatshme për treg, dhe e cila nuk mund të hiqet nga përdoruesi pa ndihmë të veçantë, pajisja e tillë do të etiketohet, duke ndjekur procedurat e specifikuar në këtë Kapitull.

KAPITULLI V **Shpërndarja**

Neni 9

- (1) Personi përgjegjës për konformitetin, importuesi dhe shpërndarësi, duke respektuar kërkesat e specifikuar në këtë kapitull, do të vendosin në qarkullim dhe shpërndajnë radio pajisje dhe/ose terminale, konformiteti sipas kërkesave themelore është njoftuar dhe se është etiketuar (vënë shenjëzim) në pajtim me kërkesat e kësaj rregulloreje.

- (2) Nëse personi përgjegjës për konformitetin ka qenë i regjistruar jashtë Kosovës, shpërndarësi i autorizuar mbahet përgjegjës për plotësimin e detyrave të referuara në këtë Rregullore.
- (3) Me vënien në qarkullim apo fillimin e shpërndarjes së 'Llojit 2' të pajisjes radio dhe/ose terminale në Kosovë, të cilat shfrytëzojnë brezet frekuencore, dhe shfrytëzimi i të cilave nuk është i harmonizuar në Kosovë, personi përgjegjës për konformitetin do të dërgoj në ARKEP informacionin e paraparë me Aneksin III) të kësaj rregulloreje, para vënies në qarkullim apo shpërndarjes së pajisjes radio dhe/ose terminale.
- (4) ARKEP do të lëshoj një konfirmim rreth pranimit të informatës dhe do të informoj rreth kufizimeve të përdorimit të spektrit të radio frekuencave të specifikuara në Kosovë, për pajisjet radio dhe/ose terminale të referuara në njoftim, brenda një periudhe kohore prej katër (4) javësh pas pranimit të informatës të specifikuar në Aneksin III) të kësaj Rregulloreje.
- (5) Nëse pas ekzaminimit të informatës së referuar në Aneksin III) të kësaj Rregulloreje, ARKEP konkludon se pajisja radio dhe/ose terminale nuk përputhet me njërën prej kërkesave themelore apo me Planin Kombëtar të Radio Frekuencave, atëherë ajo informon dërguesin e njoftimit.
- (6) Vënia në qarkullim e 'Llojit 2' të pajisjes radio dhe/ose terminale në Kosovë mund të filloj vetëm pas pranimit të konfirmimit të referuar në paragrafin 4) të këtij neni apo katër (4) javë pas dërgimit në ARKEP të informatës së specifikuar në Aneksi III) të kësaj Rregulloreje.
- (7) Personi përgjegjës për konformitetin do t'i ofroj përdoruesit apo konsumatorit të pajisjes radio dhe/ose terminale (*tutje referuar si Përdoruesi*), në dokumentacionin e dhënë, informatat e mëposhtme në gjuhët zyrtare të Kosovës.
 - 7.1 Qëllimin e përdorimit të pajisjes radio dhe/ose terminale (do të tregohet në zgjedhjen e udhëzimeve për përdorim, në këto pajisje apo në paketimin e tyre);
 - 7.2 Në territorin e Kosovës në të cilin 'Lloji 2' i pajisjes radio dhe/ose terminale është menduar të përdoret (*do të tregohen në udhëzime për përdorim dhe në paketimin e pajisjes së komunikimit*);
 - 7.3 Kufizimet e përdorimit për 'Llojin 2' të pajisjes radio dhe/ose terminale në Kosovë, duke përfshirë edhe lejet e nevojshme (*lejet për përdorim të përbashkët apo autorizimin për përdorimin e frekuencave të alokuar*) sipas zgjedhjes do të shënohen udhëzimet për përdorim, në pajisjen radio dhe/ose terminale, ose në paketimin e tyre).
 - 7.4 Llojet e lidhjeve të rrjeteve të komunikimit publik elektronik, në të cilat është menduar të lidhen pajisjet terminale (sipas zgjedhjes do të shënohen udhëzimet për përdorim, në pajisjen radio dhe/ose terminale, ose në paketimin e tyre).
 - 7.5 Konformiteti i pajisjes radio dhe/ose terminale me kërkesat themelore (deklarata e konformitetit do t'u bashkëngjiten udhëzimeve për përdorim apo do të shënohen në paketimin e pajisjes së komunikimit).
 - 7.6 Mënyra e duhur e instalimit dhe shfrytëzimit të pajisjes radio dhe/ose i terminale (do të tregohen në udhëzimin për përdorim). Nëse janë plotësuar kërkesat themelore për konformitetin e pajisjes së komunikimit, Planin Kombëtar të Radio Frekuencave, apo kërkesat e autorizimit për përdorim të përbashkët të radio frekuencave, është e nevojshme që të vëzhgohet grupimi specifik i komponentëve të pajisjes radio dhe/ose terminale (për shembull; ajror, linjës furnizuese), prodhuesi do të përshkruaj në udhëzime përdorimin e komponentëve të tilla të kësaj pajisjeje radio dhe/ose të terminale; zëvendësimi i të cilave mund të ndikoj

në konformitetin e pajisjes radio dhe/ose terminale, siç është specifikuar te kërkesat.

- (8) Plotësimi i kërkesave të referuara në paragrafin 6) të këtij neni rreth pajisjes së komunikimit, shpërndarja apo vënia në qarkullim që ka filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të kryhet nga personi përgjegjës për konformitetin jo më vonë se brenda periudhës kohore prej tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
- (9) Importuesi i pajisjes së komunikimit do të bashkëngjis tek deklarata doganore, deklaratën e konformitetit në pajtim me aktet ligjore të Rregullatorit sa u përket doganimit, duke zbatuar lirim nga procedurat doganore për qarkullim të lirë të pajisjeve.
- (10) Detyra e shpërndarjes, në rastet e referuar në paragrafët 3 dhe 4, neni 11 i kësaj Rregulloreje, është që të paralajmërojë përdoruesin se është e ndaluar përdorimi i pajisjes së tillë radio dhe/ose terminale në Kosovë. Informata do të ofrohet nga distributori në gjuhët zyrtare të Kosovës.
- (11) Gjatë shpërndarjes të 'Llojit 2' të pajisjes radio dhe/ose terminale, detyra e shpërndarësit është që të informojë përdoruesin (përfshirë edhe dhënien e informatave të specifikuar në Paragrafin 8 të këtij neni), në lidhje me rrezikun e mundshëm, sikurse edhe kufizimet dhe kërkesat që duhet të respektohen kur të përdoret pajisja e komunikimit në Kosovë. Informata do të ofrohet nga distributori në gjuhët zyrtare të Kosovës.
- (12) Në mënyrë që të mund të vlerësohet shkalla e rrezikut të interferencës së dëmshme, të cilën secila pajisje radio dhe/ose terminale do të mund ta shkaktonte në rrjetin e komunikimeve elektronike, personi përgjegjës për konformitet apo distributori duhet të jap informata të sakta dhe të plota në lidhje me pajisjen radio dhe/ose terminale, pas kërkesës së ARKEP. Distributorët apo personi përgjegjës për konformitetin gjithashtu do të japin informacione rreth shpërndarjes së mëhershme të ndonjë pajisjeje të tillë.
- (13) Kërkesat e tjera, sikurse edhe detyrat, përgjegjësia dhe kontrolli i personit përgjegjës për konformitetin dhe e distributorit sa i përket ndikimit të pajisjes radio dhe/ose terminale në shëndetin e njeriut, jetën, pronën, ambientin dhe çështjet e sigurisë do të përcaktohen nga Ligji 'Mbi sigurinë e përgjithshme të prodhimit' (Nr. 02/L-21).

KAPITULLI VI **Instalimi dhe përdorimi**

Neni 10

- (1) Lejohet që të instalohen dhe përdoren vetëm pajisje radio dhe/ose terminale të atilla, të cilat janë futur në qarkullim dhe shpërndarë sipas procedurave të specifikuara në këtë Rregullore, parametrat dhe përdorimi i të cilave përputhen me parametrat dhe përdorimin e paraqitur nga personi përgjegjës për konformitetin apo specifikacionet teknike të zbatueshme.
- (2) Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të zbatohet për pajisje radio dhe/ose terminale të referuara në paragrafin 2, neni 3 të kësaj Rregulloreje.
- (3) Radio pajisja do të instalohet dhe përdoret duke zbatuar këtë Rregullore dhe aktet tjera të Rregullatorit në lidhje me përdorimin e spektrit të radio frekuencave, sikurse edhe në pajtim me autorizimin për përdorim të radio frekuencës apo autorizimit për përdorim të përbashkët të radio frekuencës.

- (4) Nëse radio pajisja është instaluar në një objekt të palëvizshëm (strukturë) për lidhjen e përdoruesit të shërbimeve të rrjetit publik të komunikimit elektronik, operatori relevant i rrjetit publik të komunikimit elektronik do të jetë përgjegjës për konformitetin e parametrave teknikë të kësaj pajisjeje radio, me aktet ligjore të rregullatorit, të cilat lidhen me përdorimin e radio pajisjes dhe për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
- (5) Në mënyrë që të instalohet radio pajisja dhe pjesët e tyre ajrore me kabllon lidhëse (linja e transmetimit = furnizuesi) në objektin e palëvizshëm (strukturë) mbajtësi i radio pajisjes do të vizatoj projektin teknik të instalimit në konformitet me aktet ligjore të Rregullatorit në lidhje me instalimin dhe ndërtimin e rrjeteve elektronike të komunikimit.
- (6) Nëse sistemet e radio pajisjeve përbëhen nga disa tërësi të pajisjeve të komunikimit, të cilat janë instaluar, lidhur dhe menduar për funksionim në një vend të veçantë, konformiteti i sistemit të radio pajisjes me kërkesat themelore do të sigurohet nga instaluesi i sistemit, ose, nëse instaluesi nuk është i njohur – nga mbajtësi i sistemit.
- (7) Mbajtësi i radio pajisjes do të siguroj funksionimin e radio pajisjes pa dëmtim të dyanshëm të radio interferencës dhe do të përdorë radio pajisjen me fuqinë e përshtatshme minimale të radio rrezatimit dhe se lartësia ajrore për cilësinë e nevojshme të radio komunikimeve dhe largësisë komunikuese, e cila nuk tejkalon vlerat kufitare të specifikuar në leje për përdorimin e ndarjes së radio frekuencave.
- (8) Nëse pajisja radio e cila është përdorur në pajtim me autorizimin për përdorim të përbashkët të radio frekuencave, ka një lidhës për lidhjen e jashtme ajrore, përdoruesi mund të shfrytëzoj lidhjen ajrore që është e ngjashme me lidhjen ajrore të paraqitur në dokumentacionin teknik të bashkangjitur nga prodhuesi i radio pajisjes, me një përforcues të koeficientit që nuk tejkalon atë të treguar nga prodhuesi i radio pajisjes. Gjatë përdorimit të një lidhje të tillë ajrore, mbajtësi i radio pajisjes do të mbaj dhe paraqesë dokumentacionin e prodhuesit të kësaj lidhjeje ajrore, pas kërkesës nga zyrtari i autorizuar nga ARKEP.
- (9) Detyra e mbajtësit të radio pajisjes apo personit përgjegjës për përdorimin e tyre është që të mbajë projektin teknik për instalim, dokumentet që certifikojnë konformitetin e radio pajisjes, si edhe autorizimi për përdorim të ndarjes së radio frekuencave, të lëshuar nga ARKEP, gjatë tërë periudhës së përdorimit të radio pajisjes, dhe ta paraqesë atë pas kërkesës së zyrtarit të autorizuar nga ARKEP.
- (10) Detyra e mbajtësit të radio pajisjes është që të sigurojë qasje tek radio pajisja në vendin e instalimit të tyre për zyrtarët e autorizuar nga ARKEP dhe mundësinë e inspektimit (kontrollit) të parametrave teknikë të funksionimit të radio pajisjes në praninë e personit përgjegjës për përdorimin e radio pajisjes.
- (11) Mbajtësi i pajisjes radio apo personi përgjegjës për përdorimin e radio pajisjes do të ndërpresë menjëherë funksionimin e radio pajisjes, në rast se rrezikohet jeta e njeriut, prona personale dhe ambienti, që shkakton interferencë të dëmshme apo dëme në rrjetin publik të komunikimeve elektronike.

KAPITULLI VII **Kufizimet dhe Ndalesat**

Neni 11

- (1) Është e ndaluar që të shpërndahet, instalohet apo përdoret pajisja radio dhe/ose terminale nëse;
 - 1.1 Nuk është konform me një nga kërkesat themelore;

- 1.2 Konformiteti i tij nuk ka qenë i certifikuar apo vlerësuar në pajtim me këto akte apo akte të tjera të rregullatorit në lidhje me vlerësimin e konformitetit; ose
 - 1.3 Nuk është etiketuar me shenjëzim sipas paragrafit 1 dhe 4, Neni 11 të kësaj Rregulloreje.
- (2) Është e ndaluar që të instalohet dhe të përdoret radio pajisja në rastet e mëposhtme;
- 2.1 Radio pajisja e cila është përdorur për qëllimin e synuar, kërkesa e observuar për përdorim të pajisjes radio dhe/ose terminale të specifikuar nga personi përgjegjës për konformitetin, në mënyrë të përsëritshme shkakton apo mund të shkaktoj radio interferencë të dëmshme tek radio pajisja ekzistuese apo ajo e planifikuar që funksionon në konformitet me aktet e rregullatorit në lidhje me përdorimin e spektrit të radio frekuencave; ose
 - 2.2 Radio pajisja nuk është konform me planin Kombëtar të Radio Frekuencave dhe se nuk siguron konformitetin elektronik me radio pajisjet tjera.
- (3) Ndalohet përdorimi dhe shpërndarja e pajisjes terminale me pajisje identifikuese mobile me modifikim të pa-autorizuar, sikurse që është e ndaluar që të bëhen aktivitete të cilat janë të lidhura me ndonjë modifikim të pa-autorizuar të ndonjë identifikuesi të pajisjes të ndarë për pajisjen terminale apo ç'kycje e pa-autorizuar të pajisjes terminale për funksionim në një rrjet tjetër, nëse industrialisht është përshtatur që të funksionoj në një rrjet specifik të komunikimeve elektronike.
- (4) Nëse kërkesat e referuara në paragrafin 1.1 të këtij neni janë shkelur, dhe personat e autorizuar nuk marrin masa me kohë pas paralajmërimeve të dhëna nga inspektorët, atëherë ARKEP do të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me Ligjin dhe rregulloret e miratuara.
- (5) ARKEP do të përcaktoj instalimin dhe kufizimet e përdorimit për 'Llojin 2' të pajisjes së komunikimit në mënyrë që të:
- 5.1 Sigurojë interesat e mbrojtjes së Shtetit, sigurisë dhe rendit publik;
 - 5.2 Sigurojë shfrytëzim racional dhe efikas të spektrit të radio frekuencave;
 - 5.3 Eliminonjë radio interferencën e dëmshme për funksionimin e radio pajisjes tjetër;
 - 5.4 Lirojë brezet e radio frekuencave tek llojet tjera të radio komunikimeve apo sistemeve të radio komunikimeve, paraqitja e të cilëve është menduar në Planin Kombëtar të Radio Frekuencave; dhe
 - 5.5 Mbrojë vizitat e delegacioneve të zyrtarëve të lartë të huaj në Kosovë.
- (6) ARKEP në bashkëpunim me Agjencinë e Aviacionit Civil e në pajtim me aktet rregullatore të aplikueshme, në lidhje me aviacionin mund të përcaktoj kufizime dhe ndalime për/mbi përdorimin e 'Llojit 2' të pajisjes së komunikimit në objektet e aviacionit civil apo në afërsi të drejtpërdrejt të tyre, nëse një pajisje radio dhe/ose terminale e tillë shkakton apo mund të shkaktoj radio interferencë të dëmshme në pajisjet e kontrollit të radio navigimit dhe komunikacionit ajror.
- (7) Nëse konformiteti i pajisjes radio dhe/ose terminale me kërkesat themelore është certifikuar me deklaratën e konformitetit dhe se pajisja radio dhe/ose terminale është etiketuar (vënë etiketë) me shenjëzimin e referuar në kapitullin 4 të kësaj rregulloreje, operatori i rrjetit të komunikimit elektronik mund të refuzoj që të lidhë atë në rrjetin elektronik të komunikimit, të bëjë ç'kyçjen e tij nga rrjeti apo ta ndërpresë përdorimin e

tyre vetëm atëherë, nëse ARKEP ka njohuri që pajisja relevante e komunikimit shkakton dëm serioz në rrjetin elektronik të komunikimeve apo funksionin e tyre.

- (8) Në një situatë emergjente, nëse është e nevojshme që të ç'kyçet pajisja e komunikimit pa vonesë për mbrojtjen e rrjetit elektronik të komunikimeve, dhe, nëse operatori mund t'i ofroj operatorit zgjidhje tjetër menjëherë dhe pa pagesë, operatori mund të ç'kyç radio dhe/ose pajisjen terminale, konformiteti i së cilës me kërkesat themelore është certifikuar në pajtim me aktet e rregullatorit në lidhje me vlerësimin e konformitetit. Operatori do të informoj menjëherë ARKEP-in në lidhje me secilin rast të tillë.

KAPITULLI VIII Mbikëqyrja e Tregut

Neni 12

- (1) AKEP-i është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit.
- (2) Objektivat e mbikëqyrjes së tregut përfshijnë:
 - i. të sigurojë që pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit në treg përputhen me kërkesat thelbësore në këtë Rregullore;
 - ii. të kontrollojë nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore;
 - iii. të kontrollojë që fiksimi dhe përdorimi i markimit CE është korrekt dhe, nëse principet lidhur me shenjat e tjera shtesë janë respektuar.
- (3) Deklaratat e konformitetit duhet të jenë të disponueshme sa herë që ato të kërkohen nga autoritetet e inspektimit. Për më tepër, çdo produkt duhet të jetë i shoqëruar deri te përdoruesi me deklaratën e konformitetit.
- (4) Inspektimi dhe radio monitorimi i pajisjeve do të kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në rregulloren e Inspektimit dhe Radio monitorimit të miratuar nga ARKEP.

KAPITULLI IX Publikimi i Interfejsëve

Neni 13

- (1) Operatorët e Rrjeteve Publike janë të obliguar që të publikojnë specifikacionet e interfejsave të tyre sipas kërkesave të cekuar në Aneksin IV para se të fillojnë ofrimin e shërbimeve të tyre elektronike.
- (2) PNO-të janë të obliguar që të rishikojnë specifikimet teknike të publikuara njëherë në vit.
- (3) Nëse PNO ndryshon ose përditëson specifikimet e interfejsave, ata duhet që ta informojnë ARKEP menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.
- (4) Operatorët janë të obliguar që ta informojnë ARKEP-in për vendin e publikimit menjëherë pas publikimit.
- (5) Në rast se specifikimet e interfejsave do të publikohen në ueb faqen e operatorëve, ata janë të obliguar që t'i ofrojnë ARKEP-it linkun për publikimin dhe duhet ta përditësojnë linkun rregullisht.

- (6) Për elaborimin e specifikimeve të interfejsave mund të përdoret udhëzuesi në lidhje me përmbajtjen e specifikimeve të interfejsave në Aneksin V

KAPITULLI XI Dispozitat përfundimtare

Neni 14

- (1) Operatorët e Rrjeteve Publike që tashmë kanë filluar të ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike janë të obliguar që të publikojnë specifikacionet e interfejsave të tyre **brenda gjashtë (6) muajve pasi kjo rregullore të hyj në fuqi.**
- (2) Per zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Departamenti i Radio Monitorimit dhe Inspektimit si dhe Departamenti i Komunikimeve Elektronike.

Neni 15 Hyrja në fuqi

- (1) Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e saj të miratimit nga Bordi Drejtues i ARKEP dhe mbetet në fuqi derisa nuk adoptohet rregullore tjetër nga Bordi Drejtues i ARKEP.
- (2) Anekset I deri VI janë pjesë përbërese e kësaj rregulloreje.


Prishtinë, 17 /07/2013

**Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit të ARKEP**

ANEKSI I

Shenjëzimi CE

1. Shenjëzimi CE përbëhet nga shkronjat e mëdha "CE" në formën e mëposhtme:




2. Nëse madhësia e shenjëzimit CE është zvogëluar apo zmadhuar, proporcionet e dhëna nga mostra do të konstatohen. Madhësia vertikale e shenjëzimit nuk do të jetë më pak se 5mm, përveç në rastet kur nuk është e mundur për shkak të dimensioneve të pajisjes së komunikimit apo për shkaqe tjera.

ANEKSI II

Identifikuesi i 'Llojit 2' Pajisja e Komunikimit

- 1) Identifikuesi i 'Llojit 2' të radio dhe/ose pajisje terminale përbëhet nga pamja e mëposhtme;



- 2) Identifikuesi i 'Llojit 2' të radio dhe/ose pajisje terminale do të vendoset afër numrit të organit të akredituar, nëse nuk ka numër, afër shenjzimit CE, në anën e djathtë. Lartësia e identifikuesit do të jetë e barabartë me lartësinë e shenjzimit CE.

ANEKSI III

Informatat që duhet të ofrohen kur të vendoset 'Lloji 2' i Radio dhe/ose pajisjes terminale në qarkullim në Kosovë

1) Informatat rreth personave përgjegjës, të cilët janë të lidhur me prodhimin dhe vendosjen në qarkullim të radio dhe/ose pajisjes terminale;

- 1.1 Dërguesi i njoftimit (titulli, adresa, emri, mbiemri, numri i telefonit, fax-it, e-mail adresa, e personit kontaktues);
- 1.2 Personi i regjistruar në Kosovë si përgjegjës për konformitetin (titulli, adresa postare, adresa e shtëpisë, emri, mbiemri, numri i telefonit, e-mail adresa e personit kontaktues);
- 1.3 Prodhuesi i radio dhe/ose pajisjes terminale (titulli, adresa postare, adresa e shtëpisë, emri, mbiemri, numri i telefonit, e-mail adresa e personit kontaktues); dhe
- 1.4 Një përfaqësues i autorizuar i prodhuesit i regjistruar në Bashkimin Evropian (titulli, adresa postare, numri i telefonit, adresa e shtëpisë, e-mail adresa).

2) Informatat në lidhje me radio dhe/ose pajisjen terminale;

- 2.1 Lloji ose numri i modelit, ose, nëse radio dhe/ose pajisja terminale nuk ka tip ose numër të modelit, numrin serik (numrin e fabrikës) së prodhimit, apo numrin serik të prodhimit;
- 2.2 Lloji dhe shfrytëzimi;
- 2.3 Parametrat;
 - 2.3.1 Transmetimi dhe pranimi i frekuencave apo brezave frekuencore;
 - 2.3.2 Lloji i modulimit;
 - 2.3.3 Lloji i rrezatimit i cili është shenjëzuar në pajtim me Shtojcën 1) të Radio Rregulloreve të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve;
 - 2.3.4 Numri i radio kanaleve;
 - 2.3.5 Ndarja e kanaleve (largësia ndërmjet bartësit -të frekuencave të kanaleve për pajisje, të cilët mund të përdorin disa kanale);
 - 2.3.6 Lloji i qasjes në kanale (p.sh. TDMA, FDMA, CDMA, WCDMA);
 - 2.3.7 Regjimi i funksionimit (p.sh. simpleks, dupleks ose gjysmë-dupleks);
 - 2.3.8 Cikli i funksionimit (raporti në përqindje ndërmjet kohës së transmetimit nga transmetuesi dhe kohës kur transmetuesi nuk transmeton) ose kushte tjera që karakterizojnë okupimin e nja radio kanali;
 - 2.3.9 Fuqia dalëse e transmetuesit në përçuesin e transmetuesit (nëse ka një të tillë) ku është menduar që të lidhet me linjën furnizuese apo atë ajrore. Nëse fuqia mund të rregullohet, atëherë shkalla e tyre do të tregohet;
 - 2.3.10 Fuqia rrezatuese nga ajrori i pajisjes apo intensitetit të fushës elektrike apo magnetike. Nëse fuqia e transmetuesit mund të rregullohet, shkalla e tyre do të tregohet. Do të tregohet nëse fuqia e rrezatuar është përcaktuar në relacion me dipolin (ERP) ose transmetuesin izotropik (EIRP);
 - 2.3.11 Numrat, llojet dhe koeficientet e përforcimit të modeleve apo llojeve ajrore të menduar në montimin e pajisjeve; dhe
 - 2.3.12 Parametrat tjerë që karakterizojnë pajisjen (do të ofrohen pas kërkesës së ARKEP-it)

3) Informata në lidhje me konformitetin e radio dhe/ose pajisjes terminale;

- 3.1 Standardin e aplikueshëm, sikurse edhe listën e specifikacioneve teknike apo normave , të cilat janë zbatuar kur është siguruar konformiteti me kërkesat themelore të specifikuara në aktet e rregullatorit në lidhje me vlerësimin e konformitetit;





- 3.2 Një referencë të normës të akteve të rregullatorit (Paragrafi, Nën-kapitulli, Shtojca, etj) ku procedura në pajtim me të cilën vlerësimi i konformitetit të pajisjes është bërë, përshkruar; dhe
- 3.3 Numrat identifikues ose titujt e organeve të akredituara të përfshira në vlerësimin e konformitetit.
- 4) **Informata në të cilën shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe me cilat kushte pajisja është përdorur në ato shtete (*me leje të përgjithshme për përdorim të spektrit të radio frekuencave apo një leje individuale për përdorim të spektrit të radio frekuencës*).**
- 5) **Vërtetësia e informatës së dhënë do të certifikohet përmes nënshkrimit të personit me të drejtë që të nënshkruajë apo të një përfaqësuesi të tij të autorizuar.**
- 6) **Data e kompletimit të formës dhe emri i plotë.**

ANEKSI IV

Kërkesat për Publikimin e Interfejsave nga operatorët e Rrjeteve Publike Telekomunikuese

1) Operatorët që i nënshtrohen detyrimit për publikim

- 1.1. **Operatorët direkt:** Cilido operator që ofron shërbime telekomunikuese publikisht të hapura përmes një rrjeti në të cilin mund të lidhen pajisjes terminale, cilado qoftë pikë terminuese e rrjetit fiks apo radio terminal me interfejs ajror.
- 1.2. Nuk përfshihen rrjetet private apo operatorët të cilët ofrojnë shërbime jo-publike, të tilla si për një grup të limituar të shfrytëzuesve fundor.
- 1.3. **Operatorët e lidhur indirekt;** Konfiguracioni i operatorëve të tillë është dhënë në figurën 111, të cilët do të duhej të publikonin specifikat ndërlidhëse përkatëse që ndikojnë në hartimin dhe funksionimin e pajisjeve terminale.

Skenari	Kush publikon
<p>Skenari 1.</p> 	Operatori i Rrjetit B (PNO A do të ketë nevojë që t'i ofrojë PNO B informacionin teknik në rrjetin lokal të qasjes të përdorur nga PNO B)
<p>Skenari 2.</p> 	Operatori i Rrjetit B (dhe operatori i Rrjetit A në rastin kur përdoruesi ka kontratë direkte me PNO A për linja me qira)
<p>Skenari 3.</p> 	Operatori i Rrjetit A
<p>Skenari 4.</p> 	Operatori i Rrjetit A dhe Operatori i Rrjetit B. për PNO A është e mundur që specifikimi i interfejsit të jetë si në Skenarin 3. Për PNO B, vetëm informacioni mbi dhe përtej informacionit tashmë të ofruar nga PNO A duhet të publikohet p.sh. Toni i dytë i thirrjes, Sinjali i përgjigjes së palës thirrëse (Call Party Answer signal)



2) Llojet e interfejsave të përfshirë

- 2.1 Duhet të publikohen të gjitha llojet e interfejsave që janë në dispozicion publik. Këtu përfshihen të dy llojet e interfejsave, komutues dhe jo komutues. Përfshinë interfejsat për linja me qira, telefoninë, ISDN-in, të dhënat, telex-in dhe shërbimet tjera jo-zanore. Përfshinë interfejsat fiks dhe radio, duke përfshirë edhe shërbimet satelitore në dispozicion publik.

- 2.2 Nuk përfshinë interfejsat e brendshëm brenda rrjeteve, ose interfejsat ndërlidhës me operatorët tjerë. Nuk përfshin interfejsat e rrjeteve private.
- 2.3 Nuk përfshin interfejsat e rrjeteve të operatorëve apo ofruesve të shërbimeve jo-publike, që nënkupton, interfejsat e ofruar vetëm për një numër të kufizuar të përdoruesve, mirëpo përfshin Centrex-in dhe Rrjetet Virtuale Private (VPN) që zakonisht ofrohen nga Operatorët e Rrjeteve Publike me kërkesë të konsumatorëve.

3) Shkalla e detajeve që duhet të publikohen

- 3.1 Duhet të publikohen detaje të mjaftueshme për të lejuar që pajisja terminale të jetë në gjendje që të përdorë të gjitha shërbimet e ofruara përmes interfejsit përkatës.
- 3.2 Duhet të publikohen shërbimet shtesë ose tele-shërbimet që janë të kontrolluara direkt nga Operatorët Publik të Rrjeteve..
- 3.3 Mund të ketë detaje të cilat nuk duhet të publikohen lirisht, sikurse detajet e sistemeve të enkriptimit të përdorura për radio komunikime të tilla si GSM dhe tiparet e shërbimit që mund të ndërlidhen me përgjime të ligjshme. Këto detaje duhet të jenë në dispozicion vetëm në rast të marrëveshjeve jo-deklaruese.
- 3.4 Publikimet mund t'i referohen standardeve kombëtare.
- 3.5 Pa cenuar ligjin e konkurrencës, çështjet në vijim duhet të merren parasysh;

- Nëse një furnizim adekuat me pajisje terminale aktualisht ekziston ose mund të ndryshohet lehtë;
- Nëse një furnizim adekuat me pajisje terminale ka të ngjarë të bëhet për shkak të pjesëmarrjes në eksperimentet e mëhershme apo aktivitetet R&D;
- Nëse interfejsi është bazuar në një standard të publikuar, veçanërisht një standard i ETSI;
- Nëse interfejsi është bazuar në një specifikim të regjistruar/patentuar për të cilin prodhuesi mund të ketë njohuri paraprake apo ekskluzive ;
- Nëse ka ndonjë konflikt nga një apo më shumë prodhues të terminaleve të cilët gjithashtu bëjnë furnizimin me pajisje të rrjetit për PNO;
- Nëse interfejsi është për një shërbim që ka të ngjarë të jetë shërbim për tregun masiv, në krahasim me një shërbim specifik i cili nuk pritet të tërheq numër të madh furnizuesish me terminale;
- Kushte të ndryshme duhet të zbatohen për rastet kur një interfejs ekzistues ndryshohet apo tërhiqet. Periudha më të shkurtra njoftuese se sa ato për interfejsat e ri, mund të jenë më të përshtatshme;
- Ndikimi që periudha e publikimit mund të ketë për inovacionet/risitë në treg duke vonuar qasjen e konsumatorëve në shërbimet e reja;
- Nevoja për ndryshime të shpejta/të menjëhershme të interfejsave për të korrigjuar gabimet, në rastin kur nuk ka ndikim negativ në pajisjet terminale;
- Pozicioni i Pikës Terminuese të Rrjetit ndodh që duhet të merret parasysh: një interfejs i ri mund të krijojë vështirësi në stimulimin e prodhimit të pajisjeve terminale bashkërendëse, prandaj adoptimi i një NTP-je tjetër apo ekzistuese mund të shërbejë për lëshimin e suksesshëm të një shërbimi për një periudhë të caktuar kohore.

4) Trajtimi i interfejsave ekzistues, të modifikuar dhe të tërhequr

Data e rishikimit apo e elaborimit të specifikave të interfejsave duhet të referohet në publikim.

ANEKSI V

Udhëzim mbi përmbajtjen e specifikacioneve të lidhjes

Ky udhëzim shpjegon mënyrën se si operatorët definojnë specifikacionet e lidhjes

ETSI EG 201 730 Qasjet e Terminaleve qasja në rrjetet e telekomunikimit publik; Zbatimi i Direktivës 1999/5/EC (R&TTE), Neni 4(2);

Udhëzimi mbi publikimin e specifikacioneve të lidhjes duhet të përdoret

- Pjesa 1: Aspektet e përgjithshme dhe të përbashkëta
- Pjesa 2: Lidhjet analoge me tela
- Pjesa 3: Lidhjet digjitale me tela
- Pjesa 4: Lidhjet e rrjeteve kabllore me brez të gjerë multimedial

Të gjitha këto pjesë janë përshkruar në ETSI EG 201 730 Qasjet e Terminaleve në rrjetet e telekomunikimit publik,

Radio lidhjet duhet të publikohen sipas ETSI EG 201 838;

‘Kompatibiliteti elektromagnetik dhe Çështjet e Radio Spektrit (ERM); Publikimi i specifikacioneve të lidhjes sipas direktivës 1999/5/EC; Udhëzime për përshkrimin e Lidhjeve të qasjes së radios’.

Versioni i tanishëm i ETSI EG 201 730 Qasjet e Terminaleve në rrjetet e telekomunikimit publik dhe të gjitha pjesët e tyre do të publikohen në ueb faqen e internetit të ARKEP.

ANEKSI VI
Mostër e Deklaratës së Konformitetit

EC Direktiva:	
Prodhuesi:	
Lloji i Emërimit:	
Përshkrimi/ Qëllimi i përdorimit:	
Marka tregtare: Standardi i aplikuar RF:	
Standardi i aplikuar EMC:	
Standard i aplikuar për siguri:	
Personi Përgjegjës:	

Përmes kësaj _____, deklaroj se produkti i përmendur më sipër është në përputhje me kërkesat themelore të direktivës 1999/5/EC, në harmoni me ligjet e Republikës së Kosovës në lidhje me Direktivën 1999/5/EC.

Data:

Nënshkrimi
